

Europass Curriculum Vitae

Informacion Personal

Emri / Mbiemri

Adresa

Telefoni(at)

Fax

E-mail

Shtetësia

Data e lindjes

Gjinia

Punësimi i dëshiruar / Fusha e punësimit

Eksperiencat e punësimit

Data

Roli ose pozicioni i punës

Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë

Emri dhe adresa e punëdhënësit

Lloji i binzesit ose sektori

Data

Roli ose pozicioni i punës

Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë

Emri dhe adresa e punëdhënësit

Lloji i binzesit ose sektori

Data

Roli ose pozicioni i punës

Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë

Emri dhe adresa e punëdhënësit

Lloji i binzesit ose sektori

Data

Roli ose pozicioni i punës

Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë

Emri dhe adresa e punëdhënësit

Lloji i binzesit ose sektori

Data

Roli ose pozicioni i punës

Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë

H91119081D

Edmir Ballgjati

Nr. 99, Rruga e kodrave, 4001, Shkodër, Shqipëri

Fiks: -

edmirballgjati@hotmail.com

Shqiptare

19.11.1979

Mashkull

**Kërkues shkencor në fushën e etnomuzikologjisë në Departamentin e Folklorit,
IAKSA**

2003-2012

Mësues muzike

Mësimdhënie e lëndës së Historisë së Muzikës dhe Dirigjent i Orkestrës.

Shkolla e mesme artistike "Prenkë Jakova", Shkodër

Publik

2003-2008

Asistent/dirigjent pranë Bandës frymore të Bashkisë Shkodër.

Angazhim si instrumentist dhe mbështetje e procesit drejtues të ansambllit.

Qendra kulturore 'Pjetër Gaci', Shkodër

Publik

2006-2018

Pedagog i jashtëm në Fakultetin e Muzikës të Universitetit të Arteve, Tiranë.

Pedagog i lëndës Muzikologji (speciale).

Universiteti i Arteve, Blv. 'Dëshmorët e Kombit', Sheshi 'Nënë Tereza', Tiranë.

Publik

2012-2014

Dekan i Fakultetit të Muzikës

Dekan i Fakultetit të Muzikës dhe Pedagog i lëndës së Historisë së Muzikës

Akademia e Arteve, Shkodër

Publik

2014-2015

Pedagog

Pedagog i lëndës së Historisë së Muzikës, Estetikës, Folklorit dhe Analizës së Formës



Celular: 0674773279

Emri dhe adresa e punëdhënësit	Akademia e Arteve, Shkodër
Lloji i binzesit ose sektori	Publik
Data	2015-2018
Roli ose pozicioni i punës	Pedagog
Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë	Pedagog i lëndëve Historisë Muzike, Estetikë, Folklor dhe Analizë Forme
Emri dhe adresa e punëdhënësit	Departamenti i Arteve, FSHE, Universiteti 'Luigj Gurakuqi', Shkodër
Lloji i binzesit ose sektori	Publik

Arsimi dhe trajnimet

Data	2014
Titulli i kualifikimit të arritur	Doktor
Temat kryesore / aftësitë e mbuluara nga edukimi / trajnimi	Shkenca Etnologjike dhe Folklor
Emri dhe lloji i subjektit që ofroi edukimin ose trajnimin	Qendra e Studimeve Albanologjike
Data	2005-2006
Titulli i kualifikimit të arritur	Master Shkencor
Temat kryesore / aftësitë e mbuluara nga edukimi / trajnimi	Muzikologji
Emri dhe lloji i subjektit që ofroi edukimin ose trajnimin	Fakulteti i Muzikës, Akademia e Arteve, Tiranë
Data	2003-2005
Titulli i kualifikimit të arritur	Dy vite studimi universitare në Muzikologji
Temat kryesore / aftësitë e mbuluara nga edukimi / trajnimi	Muzikologji
Emri dhe lloji i subjektit që ofroi edukimin ose trajnimin	Fakulteti i Muzikës, Akademia e Arteve, Tiranë
Data	1999-2003
Titulli i kualifikimit të arritur	Diplomë e ciklit 4-vjeçar
Temat kryesore / aftësitë e mbuluara nga edukimi / trajnimi	Dirigjim
Emri dhe lloji i subjektit që ofroi edukimin ose trajnimin	Fakulteti i Muzikës, Akademia e Arteve, Tiranë

Aktivitet Shkencor

2009 - Referues në simpoziumin e festivalit të muzikantëve të rinj DAM në Prishtinë, me temë: *Mbi kuartetin e harqeve 'Polimorfi' të kompozitorit Kushtrim Gashi.*

Punimi bën një analizë strukturore dhe stilistike të veprës nën shqyrtim, gjithashtu duke analizuar mënyrën specifike të shfrytëzimit të teknikës seriale nga ana e autorit. Ekuilibri specifik artistik i veprës interpretohet edhe në kuadrin e një trajektoreje karakteristike të përthithjes së zhvillimeve bashkëkohore nga muzika shqiptare në tërësi pas viteve 1990-të.

2010 – Referues në kuadrin e aktivitetit 'Figura të shquara të artit shqiptar: Tonin Harapi dhe Ndre Mjeda', me temë: *Tonin Harapi dhe Ndre Mjeda, dy lirikë të shquar të artit shqiptar.*

Punimi merr përsipër të vërë në dukje disa afri latente në botët artistike të dy autorëve. Kjo gjë bëhet sa duke analizuar tiparet më karakteristike të krijimtarisë, aq edhe duke iu referuar pohimeve specifike të autorëve në lidhje me poetikën e tyre krijuese. Sugjerohet se shtrati i përbashkët i afrive të lartpërmendura janë dy kategoritë themelore që orientojnë krijimtarinë e autorëve: përsosmëria klasiciste dhe ndjeshmëria romantike.

2012 - Referues në Takimin VII Vjetor Shkencor Ndërkombëtar të Institutit Alb-Shkenca, Shkup, me temë: *Kënga qytetare shqiptare dhe studimi i saj në periudhën post-socialiste.*

Punimi merr në shqyrtim disa nga faktorët kryesorë që kanë ndikuar në interesin e shtuar studimor etnomuzikologjik ndaj këngës qytetare në tërësi gjatë periudhës post-socialiste. Nga njëra anë shqyrtohen faktorët e brendshëm, që kanë të bëjnë me vetë zhvillimet e studimeve etnomuzikologjike shqiptare, ndërsa nga ana tjetër, argumentohen lidhje të caktuara edhe me zhvillimet e përgjithshme social-kulturore të kohës.

2012 - Referues në konferencën shkencore gjithëkombëtare 'Identitet Kulturor Shqiptar në 100 Vjet', me temë: *Një dokument i panjohur më parë: Notizimi muzikor më i hershëm në pentagram në lidhje me këngën tradicionale shqiptare.*

Punimi prezanton zbulimin e dokumentimit më të hershëm deri tani të folklorit muzikor shqiptar, një këngë shqiptare të notizuar në pentagram nga Albert Bobovsky (ose Ali Ufki) në vitet 1640-të. Krahas deshifrimit të tekstit, bëhet edhe një transkriptim në sistemin e sotëm të notacionit muzikor. Krahas parashtrimit të interesit shumëplanësh që përbën dokumenti, punimi shtron disa hipoteza për origjinën e mundshme krahinore të këngës, sikurse edhe gre disa çështje që kërkojnë hulumtim të mëtejshëm.

2012 – Artikull studimor, botuar në 'Studime për artin', me temë: *Muzika si fenomen kulturor në prozën e Ernest Koliqit.*

Punimi merr në shqyrtim mënyrën e shfaqjes së muzikës si fenomen kulturor në prozën e shkurtër të Koliqit. Nga njëra anë shqyrtohet mënyra sesi paraqiten muzika e kultivuar dhe ajo tradicionale me referenca dhe implikime të caktuara të identiteteve sociale dhe statusit kulturor, ndërsa nga ana tjetër analizohen ato edhe në përballjen me njëra tjetrën si metafora përkatësisht të modernes dhe tradicionales, siç i përdor vetë autori në një tregim të njohur të tij.

2012 – Artikull studimor, botuar në 'Kultura Popullore' (2012), me temë: *Mbi gjendjen e studimeve të këngës shkodrane.*

Punimi merr në shqyrtim gjendjen e studimeve të këngës qytetare shkodrane, duke u përqendruar në periudhën nga fillimet e kërkimeve folkloristike-etnomuzikologjike shqiptare deri në gjysmën e shek. XX. Mangësia e kontributeve sistematike në këtë drejtim argumentohet sipas dy boshtesh: zhvillimi i vonë i etnomuzikologjisë shqiptare dhe marrëdhënia problematike e këngës qytetare me ligjërimin mbizotërues modernizues të elitave shqiptare. Kontributet specifike të periudhës interpretohen pastaj pikërisht në këtë drejtim.

2013 - Artikull studimor, botuar në revistën shkencore 'Haemus Plus' (2013/I), me temë: *Aspekte të studimit të këngës qytetare shqiptare në periudhën post-socialiste.*

Punimi bën një panoramë të përgjithshme të interesit të shtuar në studimet etnomuzikologjike shqiptare ndaj këngës qytetare në tërësi gjatë periudhës post-socialiste. Krahas parashtrimit të një tipologjie të përgjithshme të përfaqësuesve dhe qasjeve kryesore, punimi bën edhe një vlerësim kritik në këtë drejtim, duke çmuar nga ana tjetër prurjet specifike të disa autorëve kryesorë.

2013 – Artikull studimor, botuar në revistën shkencore 'Haemus Plus' (2013/II), me temë: *Some issues on Albanian urban song studies in the post-socialist period.*

Ripunim i zgjeruar i artikullit të mësipërm, duke u ndalur specifikisht mbi faktorët politiko-ideologjikë, socialë, institucionalë dhe disiplinorë që kanë nxitur vëmendjen ndaj këngës qytetare gjatë periudhës në fjalë.

2013 - Referues në *1st International Conference on 'Research and Education-Challenges Towards the Future'* ICRAE 2013 [Konferenca e Parë Ndërkombëtare mbi 'Kërkimin dhe Arsimin-Sfida drejt të ardhmes'], organizuar nga Universiteti LUIGJ GURAKUQI Shkodër, me temë: *From 'Aheng' to 'Popular song' – Similar Trends, Conflicting Aims in the Transformation of Shkodra's Traditional Song in XX Century* [Nga 'ahengu' tek 'kënga popullore' – Prije të ngjashme, synime të ndryshme në transformimin e këngës tradicionale shkodrane në shek. XX.]

Punimi merr në shqyrtim procesin specifik të transformimeve të repertorit të ahengut në tërësi rreth mesit të shek. XX dhe pastaj kalimin gradual drejt nocionit të 'këngës popullore.' Më tej gjurmohen vijmësitë themelore që shfaqen në këtë proces kalimi, pavarësisht bazave mjaft të ndryshme ideore mbi të cilat u mbështet ky proces në gjysmën e parë dhe pastaj në gjysmën e dytë të shekullit XX.

2013 – Artikull studimor, botuar në 'Kultura Popullore' (2013), me temë: *Mbi termin 'aheng'.*

Punimi merr në shqyrtim vetë termin aheng si një pikënisje për një qartësim të konceptit që referon termi. Krahas gjurmimit etimologjik (përsisht dhe turqisht), shqyrtohen edhe përdorimet e ndryshme që termi ka në gjuhën shqipe. Pas një shqyrtimi të raporteve ndërmjet termave 'aheng' dhe 'këngë popullore', trajtohet më në hollësi rasti i Shkodrës. Duke prekur edhe sferën konotative të termit, punimi mbyllet me një përcaktim të limiteve brenda të cilëve ai mund të përdoret në mënyrë të përligjur.

Aktivitet Shkencor

2015 – Referues në tryezën e rumbullakët ‘Sevdalinka, bol koja pjeva’ [Sevdalinka, dhimbja që këndon] mbajtur në Podgoricë, me temë: *Disa konsiderata mbi këngën e ahengut shkodran*.
 Punimi prek disa çështje që kanë të bëjnë me kontekstin ballkanik të repertorit të ahengut shkodran, dhe specifikisht me qarkullimin ndër-rajonat dhe ndër-etnik të këngëve. Krahas parashtrimit të disa karakteristikave kryesore stilistike dhe përmbajtësore të repertorit, preken gjithashtu edhe disa problematika që lidhen me transformimet dhe sfidat me të cilat përballlet zhvillimi i trashëgimisë së tij.

2015 – Përkthim nga italishtja i librit *L'estetica della musica* [Estetika e muzikës] nga Carl Dahlhaus (i pabotuar).

Përkthim i përdorur si tekst universitar për lëndën e estetikës së muzikës, tekst i cili përfshin në mënyrë të përmbledhur disa nga problematikat kryesore që shtron specifikisht muzika përballë reflektimit estetik. Krahas temash më ngushtësisht teorike (si psh ontologjia e veprës muzikore), trajtohen edhe autorë kryesorë (Kant, Hegel, Schopenhauer), rryma të caktuara (si formalizmi, estetika e ndjenjës, fenomenologjia), apo edhe probleme më ngushtësisht muzikore si muzika instrumentale (dhe çështja e autonomisë estetike të muzikës), muzika me program, opera, etj.

2017 – *Ishkodra ahenginde 66 türk şarkıları* [66 këngë me origjinë turke në ahengun shkodran], përmbledhje dy-gjuhëshe shqip-turqisht me transkriptime muzikore (në proces botimi).

Përmbledhje me notizime muzikore ku paraqiten 66 nga afro 107 këngë me origjinë turke që sipas Kolë Gurashit këndoheshin në ahengun shkodran. Përmbledhja është e pajisur me një hyrje dy-gjuhëshe (shqip-turqisht) ku prezantohet fenomeni i ahengut shkodran dhe rasti specifik i këngëve me origjinë turke që patën depërtuar aty. Secili notizim shoqërohet edhe nga një përkthim i përmbledhur në turqisht i tekstit shqip të këngës.

Aktivitet Artistik

2003-2012 Dirigjent në koncerte te ndryshme me orkestrën e shkollës së mesme artistike “**Prenkë Jakova**”, Shkodër.

2006 Dirigjent dhe udhëheqës artistik në koncertin vokalo-simfonik të realizuar në bashkëpunim me *Ambasadën Austriake* në Tiranë dhe *Konsullatën Austriake* në Shkodër me rastin e 250-vjetorit të kompozitorit **W.A.Mozart** në *Teatrin Migjeni* të Shkodrës.

2007 Dirigjent në koncertin e realizuar në *Teatrin Migjeni* të Shkodrës me rastin e 90-vjetorit të lindjes së kompozitorit **Prenkë Jakova**.

2009 Pjesëtar i grupit organizues të Festivalit Folklorik Kombëtar, Gjirokastrë.

2011 Dirigjent në koncertin e organizuar me rastin e 50-vjetorit të shkollës artistike ‘**Prenkë Jakova**’, Shkodër.

Aftësitë personale dhe kompetencat

Gjuha e nënës

Gjuhë të tjera

Vetë vlerësimi

Niveli European ()*

Anglisht

Turqisht

Italisht

Gjermanisht

Shqip

Të kuptuarit				Të folurit				Të shkruarit	
Dëgjim		Lexim		Ndërveprim folës		Prodhim folës			
C1	Shumë mirë	C1	Shumë mirë	C1	Shumë mirë		Shumë mirë	C1	Shumë mirë
C1	Shumë mirë	C1	Shumë mirë	C1	Shumë mirë		Shumë mirë	C1	Shumë mirë
C1	Shumë mirë	C1	Shumë mirë	C1	Shumë mirë		Shumë mirë	C1	Shumë mirë
A2	Bazë	A2	Bazë	A2	Bazë		Bazë	A2	Bazë

Aftësi sociale dhe kompetenca

Aftësi të mira pune dhe përshtatjeje në grup.

Aftësi organizative dhe kompetenca

Aftësi të mira organizative.

Aftësi teknike dhe kompetenca

Njohuri të mira të programeve bazë kompjuterike: ‘Finale’, ‘Word’, ‘Excel’.